P R O Ç E S V E R B A L

Nga seanca e këshillit të mbajtur me 31.05.2023, e premte me fillim në ora 10:00, në sallën e këshillit të komunës së Zhelinës, në prezencë të këshilltarëve dhe të Kryetari të komunës Blerim Sejdiu.

Seancën e 19-të, (nëntëmbëdhjetë) e hapi Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, dhe prezantoi propozimin e rendit të ditës me nr. Arkivor 08-809/1 në përbërje prej 6 pikave.

R E N D D I T E

1.Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 18-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

2.Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim për aplikim në thirjen e hapur nga UNDP për financimin e dokumentacionit teknik.

3.Propozim-Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.

4.Miratimi I Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Mars/2023-të.

5.Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-650/1 i datës 02.05.2023-të, nga Shkolla fillore komunale ,,Pashko Vasa'' f.Grupçin.

6.Shqyrtimi i kërkesës nr.08-608/1 i datës 20.04.2023-të, nga Elvedin Beluli nga f.Stremnicë.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari, hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Bashkim Limani.

Fjalën e mori këshilltari Bashkim Limani.

Bashkim L: Në pikën nr.6 të shtohet edhe kërkesa e Bashkim Sulejmanit nga fshati Zhelinë. Kurse si pikë tjetër e rendit të ditës kërkoj të vendoset kërkesa e Ndërmarrjes publike Komunale për ndihmë nga ana e komunës në vlerë prej 4.500.000,00 denarë.

Më pas fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Rendit të ditës t'i shtohet edhe kërkesa ime që ka të bëj në lidhje me gurthyesin në fshatin Dëbërcë.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari kërkesën e këshilltarit Bashkim Limani për Ndërmarrjen Publike komunale e hodhi në votim, ku me 5 vota pro, 7 kundër dhe 3 të përmbajtur konstatoi se kjo kërkesë nuk vihet si rend dite.

Më pas e hodhi në votim kërkesën e dytë të këshilltarit Bashkim Limani, ku me 9 vota pro, asnjë kundër dhe 6 të përmbajtur, dhe konstatoi se kjo kërkesë i shtohet rendit të ditës.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari rendin e ditës me 6 pika e hodhi në votim, u votua unanimisht.

1. Miratimi i proçesverbalit të Seancës së 18-të, të Këshillit të komunës së Zhelinës.

Kryetari i këshillit me që nuk pati diskutim për këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

2. Propozim-Vendim për dhënie Pëlqim për aplikim në thirjen e hapur nga UNDP për financimin e dokumentacionit teknik.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari dha informacione për këtë pikë. Këshilltari Naser Mislimi kërkoj fjalën.

Naser M: Ku bëhen këto projekte?

Bujar Baftjari: Është në fazë dokumentacioni.

Më pas këtë pikë e hodhi në votim, u votua unanimisht.

3. Propozim-Vendim për kriteret e përcaktimit të zonave në komunën e Zhelinës.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari hapi diskutim për këtë pikë, katër këshilltar dhanë propozimet e tyre.

Propozimi i këshilltarit Naser Mislimi:

Zona1 – 2500 den

Zona2- 1100 den

Zona3- 750 den

Zona4- 550 den

Zona5- 350 den

Propozimi i këshilltarit BashkimLimani:

Zona1- 2100 den

Zona2- 1000 den

Zona3- 800 den

Zona4- 600 den

Zona5- 400 den

Propozimi i këshilltarit Sheval Sulejmani:

Zona1- 2200 den

Zona2- 1200 den

Zona3- 600 den

Zona4- 400 den

Zona5- 300 den

Propozimi i kryetarit të këshillit Bujar Baftijari:

Zona1- 1800 den

Zona2- 1200 den

Zona3- 700 den

Zona4- 500 den

Zona5- 400 den.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim propozimin e këshilltarit Naser Mislimi, ku me 1 votë për, asnjë kundër dhe 16 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

Më pas e hodhi në votim propozimin e këshilltarit Bashkim Limani, ku me 4 vota pro, asnjë kundër dhe 13 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

Më pas e hodhi në votim propozimin e këshilltarit Sheval Sulejmani, ku me 5 vota pro, 1 kundër dhe 11 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

Më pas hodhi në votim propozimin e dhënë nga vet ai, ku me 4 vota pro, 1 kundër dhe 11 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

Më pas e hodhi në votim versionin e propozuar nga ana e komunës, ku me 4 vota kundër, asnjë votë pro dhe 13 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

4. Miratimi i Raportit financiar kuartal për realizimin e Buxhetit të komunës së Zhelinës për periudhën Janar-Mars/2023-të.

Meqë nuk pati diskutim, këtë pikë Kryetari i këshillit e hodhi në votim, ku me 9 vota pro, asnjë kundër dhe 8 të përmbajtur konstatoi se kalon.

5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 08-650/1 idatës 02.05.2023-të, nga Shkolla fillore komunale ,,Pashko Vasa'' f.Grupçin.

Edhe te kjo pikë nuk pati diskutim, kështu që Kryetari i këshillit e hodhi në votim, u votua unanimisht.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr.08-608/1 i datës 20.04.2023-të, nga Elvedin Beluli nga f.Stremnicë dhe shqyrtimi i kërkesës me nr. 08- 832/1 të datës 31.05.2023 nga Bashkim Sulejmani nga fshati Zhelinë.

Kryetari i këshillit Bujar Baftijari hapi diskutim, fjalën e mori këshilltari Sheval Sulejmani.

Sheval S: Kërkoj info nga administrata e komunës që të na tregoi a posedon komuna toka sociale për këtë kategori.

Informacione për këtë dha Kryetari i komunës Blerim Sejdiu.

Kryetari i këshillit këtë pikë e hodhi në votim, ku me 2 vota për, 10 të përmbajtur dhe asnjë kundër konstatoi se nuk kalon.

Më pas në votim e hodhi edhe kërkesën nr. 2 të propozuar nga këshilltari Bashkim Limani, ku me 2 vota për, asnjë kundër dhe 10 të përmbajtur konstatoi se nuk kalon.

Në fund Kryetari I këshillit i dha hapësirë për informacione kërkesës së parashtruar të këshilltarit Sheval Sulejmani sa i përketë Gurores në fshatin Dëbërcë, kërkesë e parashtruar me datën 28.04.202-të.

Sheval Sulejmani e mori fjalën.

Sheval S: Kërkesa ime ka të bëj konkretisht me punimet që bëhen në hyrje të fshatit Dëbërcë, duke i pasur parasysh shqetësimet e të gjithë banorëve të fshatit unë e mora këtë hap.

Informacione të hollësishme dha Kryetari i komunës Blerim Sejdiu.

Më pas Kryetari i këshillit Bujar Baftijari e konstatoi të mbyllur seancën e 19-të të këshillit të komunës së Zhelinës.

Nr. 08-809/2
31.05.2023-të
Zhelinë

Proçesverbalist
Albineta Alija

Këshilli i Komunës së Zhelinës
Kryetar
Bujar Baftijari